




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 04.10.2017

Vendim
Nr. 88, datë 04.10.2017


**PËR POZICIONIN E PUNËS "LABORANT I QENDRËS KËRKIMORE
SHKENCORE" PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE**

Në mbështetje të nenit 66 "Personeli ndihmësakademik", nenit 26 dhe nenit 38 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në funksion të zbatimit të strukturës organizative të UV-së, si dhe bazuar në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike me nr 831 prot, datë 29.09.2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.09.2017

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pozicionit të punës të përcaktuar në Vendimin nr. 69, datë 30.06.2017 të Senatit Akademik "Për miratimin e propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike për kualifikimin e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ pranë Qendrës Kërkimore Shkencore" nga **personel ndihmësakademik me karakter administrativ në personel ndihmësakademik me karakter mësimor ("laborant")**.
2. Nivel kualifikimi punësimi për këtë pozicionin është **arsimi i lartë**.
3. Ky vendim t'i bashkëlidhet vendimit të senatit nr. Nr 10, datë 27. 01. 2017.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike, Përgjegjësi i QKSH-së pranë këtij fakulteti, Administratori, Drejtorja e Financave dhe Realizimit të Buxhetit si dhe Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit Zyrtar.
5. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.